

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>2</sup>	Data e përgjigje <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
1.	16.01.2023	Kërkesë për informacion nga E.N. me profesion gazetar, në lidhje mbi gjendjen juridike të shtetasit P.Gj.	16.01.2023	<p>Në lidhje me kërkesën tuaj të datës 16.01.2023, me anë të cilës kërkoni informacion në lidhje me gjendjen juridike të shtetasit P.Gj., ju informoj si më poshtë:</p> <p>Së pari: Bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në përcaktimet e Kodit të Procedurës Penale, ju informojmë se ushtrimi i ndjekjes penale kryhet nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë e cila ka si kompetencë tokësore rrethin e Lezhës.</p> <p>Së dyti: Ju informoj se në rastin konkret, gjykata ju orienton që në referim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” për marrjen e këtij informacioni për shtetasin P.GJ. duhet ti drejtoheni Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë i cili është dhe institucioni kompetent sipas ligjit për ushtrimin e ndjekjes penale.</p>	E plotë	S’ka
2.	06.02.2023	Kërkesë nga I.M. me profesion gazetar, për të dhëna statistikore.	08.02.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 06.02.2023 e paraqitur në formë elektronike, në bazë të ligjit nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” me anë të cilës kërkoni informacion:</p> <p><i>Sa çështje me objekt dhunë në familje janë regjistruar gjatë vitit 2022?</i></p> <p><i>Sa urdhëra mbrojtje janë dhënë për</i></p>	E plotë	S’ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p><i>gratë gjatë vitit 2022?</i></p> <p>Sa më sipër bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” gjykata brenda afatit ligjor ju vendos në dispozicion të dhënat e kërkuara si më poshtë:</p> <p>Në lidhje me pikën e parë ku kërkoni sa është numri i çështjeve të regjistruara me objekt dhunë në familje për vitin 2022, ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra në të dhëna statistikore rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë janë regjistruar në total 95 (nëntëdhjetë e pesë) çështje me objekt dhunë në familje. Në lidhje me pikën e dytë ku kërkoni sa është numri i urdhrave të mbrojtjes që janë dhënë për femrat për vitin 2022, ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra në të dhëna statistikore rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë janë lëshuar total 74 (shtatëdhjetë e katër) urdhra mbrojtje.</p>		
3.	14.02.2023	Kërkesë për informacion nga F.N. me profesion gazetarë, kopje të të gjitha akuzave të konfirmuara, akuzat që janë propozuar dhe gjykimeve në rastet që zhvillohen para kësaj gjykate, për veprën penale të sjelljes së dhunshme në ngjarje sportive apo tubime publike në	20.02.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 14.02.2022 e paraqitur në formë elektronike, ku kërkoni:</p> <p>Kopje të të gjitha akuzave të konfirmuara, akuzat që janë propozuar dhe gjykimeve në rastet që zhvillohen para kësaj gjykate, për veprën penale të sjelljes së dhunshme në ngjarje sportive apo tubime publike në periudhën prej datës 01.01.2020 deri</p>	E plotë	S’ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		periudhën prej datës 01.01.2020 deri më 31.12.2022.		më 31.12.2022.Sa më sipër bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në lidhje më sa kërkoni brenda afatit ligjor ju informojmë se: Sipas verifikimeve të bëra nuk rezulton asnjë akuzë të konfirmuar, të propozuar apo gjykuar për veprën penale të sjelljes së dhunshme në ngjarje sportive apo tubime publike në periudhën prej datës 01.01.2020 deri më 31.12.2022 pranë Gjykatës së Rrethit Lezhë.		
4.	19.04.2023	Kërkesë nga E.L. me profesion gazetares, për të dhëna statistikore dhe kopje të vendimeve gjyqësore për veprat penale të parashikuara nga neni 100, 101, 107/a, 108, 108/a, 117,121/a/3 të Kodit Penal.	02.05.2023	Në lidhje me pikën e parë ku kërkoni sa është numri i çështjeve penale të gjykuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprat penale të parashikuara nga neni 100, 101, 107/a, 108, 108/a, 117, 121/a/3 të Kodit Penal për periudhën Janar 2020-Mars 2023, ju informojmë se sipas verifikimeve të bëra në të dhënat statistikore rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Lezhë kanë përfunduar çështjet si vijon. Në lidhje me pikën e dytë ku kërkoni kopje të anonimizuar të vendimeve gjyqësore për veprat e mësipërme përgjatë periudhës Janar 2020-Mars 2023, bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” këto vendime ju dërgohen në formë të anonimizuar me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale të cilat ndodhen të përshkruara në vendimet e mësipërme.	E plotë	S’ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

5.	27.04.2023	Kërkesë nga E.H. me profesion gazetar, informacion për dispozitivët e vendimeve të masave të sigurimit të personave të vënë nën akuzë për vrasjen e A. N., bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.	27.04.2023	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit” ku kërkoni dispozitivët e vendimeve për persona të vendosur nën akuzë për vrasje të shtetasit A. N., ju informojmë se: Në kushtet që kërkesa Juaj lidhet me fazën e hetimeve paraprake dhe duke qenë se veprimet paraprake hetimore mbahen sekrete nga organet ligjzbatuese për mbarëvajtjen e hetimeve, nuk disponohen të dhëna as në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.	E plotë	S’ka
6.	08.05.2023	Kërkesë për informacion nga R.D., redaktore e Report TV, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkoj informacion si me poshtë: 1. Kur do të zhvillohet seanca gjyqësore për rivlersimin e masave të sigurisë për shtetasit I.A. dhe P. P.? 2. A do të lejohet media për të ndjekur seancën për masën e sigurisë?	09.05.2023	Në përgjigje të kërkesës Tuaj të datës 08.05.2023 në lidhje me pjesmarrjen tuaj si përfaqësuese e medias në seancë gjyqësore për rivlersimin e masave të sigurisë për shtetasit I. A. dhe P. P., bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit” ju informojmë si me poshtë: Gjykata pasi u njoh me kërkesën tuaj ju informon se seanca gjyqësore do të zhvillohet më datë 09.05.2023, ditë e marte, ora 12:20 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Sa më sipër ju informojmë se bazuar me përcaktimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa e paraqitur nga ana juaj për praninë tuaj në	E plotë	S’ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				seancën gjyqësore që do të zhvillohet për të arrestuarit P.P. dhe I.A, është në vlerësimin e gjyqtarit të çështjes për rastin konkret.		
7.	24.05.2023	Kërkesë nga Gj.F. me profesion gazetar, informacion mbi numrin e çështjeve të gjykuara përgjatë viteve 2020, 2021, 2022 dhe 2023, deri më datë 23.05.2023 për vepren penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal.	24.05.2023	Në lidhje me kërkesën tuaj të datës 24.05.2023 ku kërkonte informacion mbi numrin e çështjeve të gjykuara përgjatë viteve 2020, 2021, 2022 dhe 2023, deri më datë 23.05.2023 për vepren penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal. Bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e informimit” ju informojmë si më poshtë; Viti 2020 - 1 (një) çështje penale, Viti 2021 - 2 (dy) çështje penale, Viti 2022 - 0 (zero) çështje penale, Viti 2023 deri më datë 23.05.2023 - 0 (zero) çështje penale. Në lidhje me pikën (3) ku parashtroni pyetjen se “A ka raste që ky denim nuk mund të merret për shkak të mungesës së provave dhe paraqiten vazhdimisht prova për raste të tilla” ju informojmë se kjo është në vlerësimin e gjykatës rast pas rasti.	E plotë	S’ka
8.	29.05.2023	Kërkesë për informacion bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj informacion si më poshtë: 1. Sa është numri i personave të denuar për krime	06.06.2023	Në lidhje me kërkesën tuaj të datës 30.05.2023 ku kërkonte informacion mbi numrin e personave të denuar për “Vepra Penale Kundër Mjedisit” gjatë 5 (pesë) viteve të fundit dhe vendimet e arsyetura për këto çështje, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e	E plotë	S’ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		<p>mjedisore gjatë 5 (pesë) viteve te fundit?</p> <p>2. Kërkoj të me vihen në dispozicion vendimet e arsyetuera, me të denuar për krime mjedisore?</p>		<p>informimit” sipas verifikimeve të bëra në të dhënat statistikore ju informojmë sipas Tabeles për “Veprat penale kundër mjedisit”, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.</p>		
9.	19.06.2023	<p>Kërkesë nga E.H. me profesion gazetar, kërkesë për informacion: Bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejten e informimit", unë E. H. gazetar i Report Tv dhe Shqiptarja.com kërkoj informacion si më poshtë:</p> <p>1. Cili është vendimi i dhënë për shtetasin J. L., i vënë nën akuzë për veprën penale “Shpërdorim Detyre”?</p> <p>2. Cila është masa e denimit e kërkuar nga prokuroria dhe a ka përfituar nga gjykimi i shkurtuar?</p>	19.06.2023	<p>Në vijimësi të komunikimit në lidhje me kërkesën tuaj të datës 19.06.2023, kërkesë kjo e bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” me të cilën kërkonte se cili është vendimi i dhënë për shtetasin J.L. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ju informojmë se; Në lidhje me pikën tuaj të parë se cili është vendimi i dhënë për shtetasin J. L., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal rezulton si vijon.</p>	E plotë	S’ka
10.	10.07.2023	<p>Kërkesë për informacion nga G.E., gazetar i Report Tv ku kërkonte informacion: 1.Sa raste janë sjellë për gjykim në periudhën 2010-korrik 2023 për subjektet e licensuara dhe për personat apo subjektet që në mënyrë informale ushtrojnë veprimtarinë e guroreve dhe</p>	24.07.2023	<p>Në lidhje me kërkesën tuaj të datës 10.07.2023, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas verifikimeve të bëra në të dhënat statistikore pranë kësaj gjykate ju informojmë se rezultojnë të dhënat si më poshtë në tabelat statistikore.</p>	E plotë	S’ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		të furrave të gëlqeres? 2. Na vendosni në dispozicion një kopje të vendimeve gjyqësore, shoqëruar me kërkesat dhe aktet e depozituara nga prokuroritë përkatëse.				
11.	11.09.2023	Kërkesë për informacion nga Emisioni Investigativ Stop, gazeta D.B., bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkon vendimin e zbardhur me pale GJ.S. dhe M.S.	27.09.2023	Në vijim të kërkesën tuaj të datës 11.09.2023 e protokolluar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me nr.794 prot, kërkesë kjo e bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” me të cilën kërkoni vendimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit Gj. S., ju informojmë se vendimin e kërkuar për këtë rast penal e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të gjykatës në formë të anonimizuar automatikisht. Më sipër ju vendosim në dispozicion linkun e gjykatës në të cilin mund të aksesoni vendimin për shtetasin Gj. S. si dhe bazuar në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” vendimi gjenerohet automatikisht i anonimizuar me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale të cilat ndodhen të përshkruara në vendimin e mësipërm.	E plotë	S’ka
12.	09.10.2023	Kërkesë për informacion nga E. D., gazeta e Abc News, autore e dokumentarit	11.10.2023	Në vijim të komunikimit në lidhje me kërkesën tuaj të datës 09.10.2023, kërkesë kjo e bazuar në	E plotë	S’ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		<p>“Gjerat Tona”. Kërkojmë vënien në dispozicion të vendimit penal P.B.</p>		<p>ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” me të cilën kërkoni vendimin për çështjen penale në ngarkim të shtetasit P. B. Sa më sipër ju informojmë se nga verifikimi rezulton se vendimi penal për këtë shtetas ka në përmbatje të dhëna sensitive dhe personale në lidhje edhe me persona të tjerë apo deklarime të dhëna për interesa të gjyqimit apo ngjarjes. Në këto kushte, duke qene se rasti për shtetasin M. B. është në hetim nga prokuroria (dhe mund të përbëjë sekret hetimor referuar përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale) për marrjen e këtij vendimi ju sugjerojmë që ti drejtoheni Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, pasi vendimi i kërkuar nga ana juaj mund të ndikojë në mbarëvatjen e hetimeve penale duke qenë se çështja është në fazën e hetimeve paraprake. Për këtë shkak nuk mund të vendoset në dispozicionin vendimin penal i dhënë për shtetasin P. B.</p>		
13.	23.11.2023	<p>Kërkesë për informacion, bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit" më datë 31.10.2023 jemi vene ne dijeni se një 46-vjeçar është shpallur në kërkim nga Policia e Lezhës, pasi ka goditur një punonjës</p>	24.11.2024	<p>Në lidhje me kërkesën tuaj të datës 23.11.2023, bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” me anë të cilës kërkoni informacion për ngjarjen e datës 31.10.2023. Ju bëjmë me dije se në lidhje me këtë ngjarje nuk ka një çështje në shqyrtim</p>	E plotë	S’ka



## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		<p>të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, në ambientet e jashtme të këtij institucioni. Per kete ngjarje edhe njoftuar se; Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Lezhë shpallën në kërkim shtetasin L. A., 46 vjeç, banues në Kurbin, pasi në ambientet e jashtme të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ka goditur për shkak të detyrës, një punonjës (specialist) të këtij institucioni. 46-vjeçari nga Kurbini i shpallur ne kerkim rezulton se eshte bashkëshorti i një punonjëse në Gjykatën e Lezhës.</p> <p>Per shkak se ceshtja paraqet interes te larte publik, bazuar ne ligjin 119/2014 "Per te drejten e Informimit" kerkojme te na informoni ne lidhje me rastin, dhe reagimin qe ka bere gjykata duke qene se kemi te bejme me nje ngjarje e cila cenon imazhin publik te gjykates.</p>		<p>gjyqësor pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.</p> <p>Nga ana tjetër në lidhje me këtë ngjarje është filluar një procedurë në lidhje me përcaktimin e ekzistencës së shkeljeve disiplinore nga ana e punonjësve gjyqësore. Procedura është në vijim dhe nuk ka ende një vendimmarrje.</p> <p>Për sa i përket një reagimi publik, Gjykata thekson faktin se në kushtet kur ekziston mundësia potenciale që ngjarja të jetë pjesë e shqyrtimit gjyqësor, çdo reagim publik krijon rrezikun e perceptimit të njëanshmërisë.</p>		
14.	07.12.2023	Kërkesë për informacion, bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejten e informimit",	15.12.2023	Në lidhje me kërkesën tuaj të datës 07.12.2023, ku kërkonit informacion në lidhje me veprën penale të parashikuar	E plotë	S'ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		kërkon informacion në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 202/a të Kodit Penal, gjatë viteve 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023.		nga neni 202/a të Kodit Penal, gjatë viteve 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 ju informojmë se: Bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e informimit” ju informojmë se për veprën penale të parashikuar nga neni 202/a i Kodit Penal, sipas verifikimeve të të dhënave statistikore gjatë viteve 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 nuk rezulton se ka çështje penale të rregjistruara për këtë veprë penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.		
15.	11.12.2023	Kërkesë për informacion, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” na informoni nëse ka akoma ndonjë vendimarrje për ngjarjen e datës 31.10.2023, për të cilën na keni informuar se është filluar një procedurë disiplinore për përcaktimin e shkeljeve disiplinore.	20.12.2023	Në lidhje me kërkesën tuaj të datës 11.12.2023, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit” me anë të cilës kërkonti informacion nëse ka ndonjë vendimarrje për ngjarjen e datës 31.10.2023, për të cilën ju kemi informuar se është filluar një procedure disiplinore për përcaktimin e shkeljeve disiplinore. Së më sipër bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” Ju informojmë se për rastin konkret nuk ka akoma një vendimarrje.	E plotë	S’ka
16.	21.12.2023	Kërkesë për informacion nga M.V., ku kërkon vendimin penal për shtetasin F.P., si dhe çdo vendim I marrë në lidhje me të.	03.01.2024	Në vijim të komunikimit sa i përket kërkesës tuaj gjykata bazuar në ligjin Nr.119/2014 "Për Të Drejtën për Informim" ju kërkoi që në lidhje me kërkesën tuaj të dërgonit dhe karte ID.	E plotë	S’ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Gjithashtu aksesimi në të dhëna mund të ofrohet dhe për qëllime gazetarie, letrare, artistike apo shkencore. Në rastin konkret, ju si kërkues, nuk paraqisni asnjë dokument që të vërtetojë lidhjen tuaj me të dhënat që kërkoni e për rrjedhojë të bëhet i mundur dhe verifikimi i qëllimit të përdorimit të këtyre të dhënave nga ana juaj.</p> <p>Në mungesë të një karte gazetari, dokumenti identifikimi, etj. nga ana jonë nuk mund të verifikohet ekzistenca e së drejtës tuaj për tu njohur me informacionin që kërkoni tju vihet në dispozicion.</p> <p>Në kushtet kur vendimi dhe dosja gjyqësore e kërkuar nga ana juaj përmban të dhëna personale të subjekteve të tjera të ndryshëm nga ju, ku pjesë e këtyre subjekteve është dhe një i mitur në konflikt me ligj, si dhe kur ju nuk paraqitet asnjë dokument për të vërtetuar qëllimet e kërkimit të këtyre të dhënave, çmujmë se kërkesa juaj është e pabazuar në legjislacionin në fuqi dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.</p>		
--	--	--	--	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--

<sup>1</sup> Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

<sup>2</sup> Data e regjistrimit të kërkesës.

<sup>3</sup> Përmbledhje e objektit të kërkesës duke anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

<sup>4</sup> Data e kthimit të përgjigjës.

## **REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**

<sup>5</sup> Përmbajtja e përgjigjes duke anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

<sup>6</sup> Përgjigja jepet E plotë / E kufizuar / E Refuzuar / E deleguar.

<sup>7</sup> Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.